



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -

Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti i Buxhetit - Budget Department - Budzet Department

DATE	30.09.2022
REFERENCE	MF - 222 / 2022
PËR/ZA/TO:	Z. Nuhi Mani, Zyrtar Kryesor Financiar, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
CC	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
NGA/OD/FROM:	Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinionimi i Departamentit të Buxhetit për vlerësimin e ndikimit buxhetor për Projektligjin për Mbështetjen e Punëve Publike

I nderuari z. Mani,

Bazuar në kërkesën për vlerësimin e ndikimit buxhetor për Projektligjin për Mbështetjen e Punëve Publike, të paraqitur nga propozuesi: Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), obligimin sipas Nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe sipas Nenit 18 të Ligjit Nr. 08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, Departamenti i Buxhetit paraqet:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PROJEKTLIGJIT

Ky projektligj ka për qëllim të krijojë një mekanizëm për kompensimin deri në një masë të caktuar të rritjes së çmimeve të materialeve ndërtimore dhe punëve përcjellëse në kontratat për punë të lidhura në mes të Autoriteteve Kontraktuese dhe Operatorëve Ekonomikë konform Ligjit përkatës për Prokurim Publik.

OPINIONI I PAVARUR I DEPARTAMENTIT TË BUXHETIT NË VLERËSIMIN E NDIKIMIT BUXHETOR (VNB)

Aprovimi i Projektligjit për Mbështetjen e Punëve Publike, do të rezultonte në krijimin e një mekanizmi për kompensimin deri në një masë të caktuar të rritjes së çmimeve të materialeve ndërtimore dhe punëve përcjellëse (sipas nenit 4 të këtij projektligji) në kontratat për punë të lidhura në mes të Autoriteteve Kontraktuese dhe Operatorëve Ekonomikë konform Ligjit përkatës për Prokurim Publik.

Sipas nenit 8, i cila ka të bëjë me përlogaritja e kompensimit për inflacion, paragrafi 1 Ministria përgjegjëse për Financa publikon formularin me formulë përkatëse në bazë të së cilit përlogaritet norma për kompensim. Ky formular publikohet brenda shtatë (7) ditëve kalendarike nga hyrja në fuqi e këtij Ligji.

Sipas paragrafit 2 të nenit 4, Formula përmban pozicione të caktuara për secilin material ndërtimor dhe një pozicion për punët përcjellëse ku përmes peshës së secilit pozicion, peshës së tyre në kontratën e punës, dhe çmimit bazë e çmimit të tregut për to përcaktohet norma për kompensim.

Sipas formularit, përqindja maksimale e kompensimit për punët përcjellëse, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji, nuk mund të kalojë vlerën e inflacionit sipas Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit të publikuar nga Agjencia përkatëse për Statistika. Pavarësisht normës për kompensim të përcaktuar sipas formularit, norma për kompensim nuk mund të kalojë njëzetë për qind (20%) të vlerës totale të faturës bazë.

Nga kjo që u tha më lartë zbatimi i këtij projektligji nuk do të krijoj kosto shtesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, ku sipas paragrafi 2 të nenit 10 të këtij projektligji, Autoriteti Kontraktues realizon procesin e shpenzimeve të faturës së kompensimit, nga ndarjet aktuale buxhetore të projektit, në kodin përkatës ekonomik, sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Përfundim:

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Departamenti i Buxhetit vlerëson se Projektligji për Mbështetjen e Punëve Publike, nga aspekti i ndikimit buxhetor nuk krijon kosto shtesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, duke u mbështetur në paragrafi 2 të nenit 10 të këtij projektligji, ku thuhet se Autoriteti Kontraktues realizon procesin e shpenzimeve të faturës së kompensimit, nga ndarjet aktuale buxhetore të projektit.

Përgatitur nga:

Antigona Bekaj, Analiste e lartë e buxhetit



Konfirmoi:

Milaim Aliu, Udhëheqës i divizionit të buxhetit qendror

